



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 419 Prot.

Tiranë, më 20 . 1 . 2022

URDHËR

Nr. 18 , datë 20 . 1 . 2022

PËR

**NDËRPRERJEN E PROCESIT MËSIMOR NË TË GJITHA INSTITUCIONET
ARSIMORE PUBLIKE DHE JO PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 26, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jo publike për një periudhë 3 (tre) ditore, duke filluar nga data 24.1.2022 - 26.1.2022, për shkak të uljes së temperaturave në vlera të konsiderueshme.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Sekretari i përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet arsimore.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSHI

